

VAZHDIMI I SHKOLLIMIT

FAZA KYÇE 3

PRINDËRIT U NDIHMOJNË TË RINJVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË

KËSHILLAT KRYESORE

Interesohuni për ato që mëson fëmija juaj dhe nxiteni atë që t'ju flasë për mësimet e veta.

Lavdërojeni fëmijën tuaj kur ai ose ajo të ketë bërë diçka mirë.

Sigurojani fëmijës një hapësirë të qetë për t'i kryer detyrat e shtëpisë.

Mbajeni mend që fëmijët zhvillohen me shpejtësi të ndryshme. Disa mund të kenë probleme për një kohë të caktuar e pastaj të përparojnë me shpejtësi më vonë. Nëse mendoni që fëmija juaj ka nevojë për ndihmë plotësuese, bisedoni me mësuesit.

Njoftojeni shkollën po ashtu edhe nëse fëmijës i duken mësimet shumë të lehta – ata do të jenë në gjendje t'i ndihmojnë që të synojë për më tepër.

Ndihmojini me detyrat e shtëpisë dhe me përsëritjet. Ju po ashtu mund të ndihmoni në zhvillimin e aftësive menduese të fëmijës tuaj. Website-i vijues posedon shumë informacione të dobishme për prindërit lidhur me fazën kyçe 3, përfshirë këtu edhe këshillat se si t'i ndihmoni të rinjve në procesin e mësimin.

www.parentscentre.gov.uk/learnjournal/index_ks3.cfm?ver=graph

HYRJE:

Faza kyçe 3

Koha e fëmijës tuaj në shkollë është e ndarë në *faza kyçe*. Ekzistojnë katër faza që përfshijnë moshat prej 7 deri në 16 vjeç. Ndërmjet moshës 11 dhe 14 vjeçe (klasa e 7-të deri në klasën e 9-të), të rinjtë kalojnë fazën e 3-të. Gjatë kësaj faze ata mësojnë për lëndë që janë pjesë të Planprogramit Mësimor Kombëtar e pos kësaj edhe disa lëndë të tjera siç është edukimi fetar (shikoni më poshtë).

Planprogrami Mësimor Kombëtar

Planprogrami Mësimor Kombëtar është përpiluar për të ofruar mundësi për të gjithë nxënësit që të mësojnë dhe të përparojnë. Ai gjithashtu synon që të çojë përpara zhvillimin shpirtëror, moral, social dhe kulturor, dhe t'i përgatisë fëmijët dhe të rinjtë për jetën. Thënë ndryshe, Planprogrami Mësimor Kombëtar tregon se çka mund të presin të mësojnë të gjithë nxënësit nga Anglia nga mosha 7 deri në 16 vjeç, përkrah synimeve që fëmija juaj do t'i ketë arritur nga aspekti i aftësive, njohurive dhe kuptimit.

PASQYRA E LËNDËVE

Anglishtja

Anglishtja përqendrohet në katër shkathtësi kyçe – *të folurit e qartë, të dëgjuarit me vëmendje, të lexuarit me kujdes dhe të shkruarit rrjedhshëm*. Anglishtja u ndihmon nxënësve ta shprehin vetveten në mënyrë krijuese dhe i jep shtytje vetëbesimit të tyre për sa i përket të folurit në publik dhe të shkruarit për të tjerët.

Matematika

Nxënësit mësohen se si ta përdorin dhe ta zbatojnë matematikën në problemet gjithnjë e më të vështira. Ajo përfshin *aritmetikën dhe algjebren; format, hapësirën dhe matjen; dhe përpunimin e të dhënave*.

Shkenca

Shkenca mëson metodat e *hulumtimit shkencor*. Fëmija juaj studion *proceset jetësore dhe gjërat e gjalla* ku përfshihen seksi dhe ato që na nevojiten për shëndet të mirë; *materialet dhe tiparet e tyre* përfshirë reaksionet kimike dhe *proceset fizike*. Të rinjtë mësojnë për lëvizjen e Tokës dhe për sistemin diellor.

Dizajni dhe Teknologjia

'D&T' ia hedh një sy prodhimeve dhe shikon se si punojnë, si përdoren, a i përmbushin nevojat e shfrytëzuesve, a i shfrytëzojnë si duhet materialet dhe çfarë ndikimesh mund të kenë ato prodhime në mjedis. Nxënësit nxjerrin prodhime të vërteta prej duarve të tyre.

Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit (ICT)

Në fazën kyçe 3 nxënësit i shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur teknologjitë e reja dhe burimet e informacionit. Ata mësojnë si të kërkojnë informacione në mënyrë më gjithëpërfshirëse.

Historia

Nxënësit do të mësojnë për historinë lokale, kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare nëpërmjet gjashtë lëmive studimore: Britania 1066-1500; Britania 1500-1750; Britania 1750-1900; një studim evropian para vitit 1914; një shoqëri afrikane, amerikane, aziatike ose australo-aziatike para vitit 1900; një studim botëror pas vitit 1900. Nxënësit do të shfrytëzojnë një sërë burimesh të informacionit për t'u informuar hollësisht lidhur me aspektet e së kaluarës.

Gjeografia

Nxënësit mësojnë t'i shfrytëzojnë shkathtësitë gjeografike për t'u informuar për vende të ndryshme, për mostra të ndryshme në mjediset natyrore dhe njerëzore dhe për shkaqet e tyre. Ata studiojnë për mënyrën si ndryshojnë mjediset dhe për mënyrat se si mund të përkujdesemi për to.

Të rinjtë studiojnë për dy shtete dhe 10 kapituj: *moti dhe klima, ekosistemet, popullsitë, vendbanimet, veprimtaritë ekonomike, zhvillimi, çështjet e mjedisit, çështjet e pasurive natyrore, proceset tektonike* (siç janë tërmetet), *proceset gjeomorfologjike* (efektet e ujit dhe akullit).

Të rinjtë tuaj do të kryejnë punë kërkimore në terren jashtë klasës.

Gjuhët e huaja moderne

Të rinjtë mësojnë së paku një gjuhë moderne të huaj në fazën kyçe 3. Atyre u mësohen blloqet themelore ndërtuese të gjuhës, përfshirë gramatikën dhe fjalorin. Nxënësit mësojnë po ashtu për shtetet dhe kulturat ku flitet gjuha përkatëse dhe gjithashtu punojnë me materiale nga jeta e përditshme gjegjëse siç janë gazetatat, librat dhe programet televizive.

Arti dhe Dizajni

Të rinjtë tuaj do të mësohen të hulumtojnë dhe të zhvillojnë ide të nxjerra nga imagjinata e tyre, përvoja dhe vërtetimet dhe të përdorin një varg të zgjeruar materiale, veglash, teknikash dhe procesesh. Nxënësit i rishikojnë punimet e veta dhe të tjerëve duke treguar se çfarë mendojnë dhe çfarë ndjejnë për to.

Muzika

Nxënësit e kësaj moshe u bien instrumenteve dhe kompozojnë muzikë të stileve të ndryshme duke e rritur dalëngadalë vetëdijen për teknikat muzikore. Ata punojnë veçmas dhe në grupe.

Shtetësia

Duke i ndjekur çështjet dhe ngjarjet e ditës në lajme, të rinjtë mësohen të mendojnë me kujdes mbi politikën, natyrën shpirtërore, moralin, shoqërinë dhe kulturën, dhe të flasin për idetë e tyre në klasë. Ata mësojnë se si ndikohet jeta jonë nga qeveria, ligji, feja dhe ekonomia.

Edukimi Fizik (PE)

Shkollat mësojnë *tri* nga veprimtaritë e listës vijuese, njëra prej të cilave duhet të jetë vallëzimi ose gjimnastika: *vallëzimi, gjimnastika, noti dhe siguria në ujë, atletika, veprimtaritë e jashtme dhe aventuriste.*

Edukimi Fetar (RE)

Shkollat janë të detyruara të mësojnë edukimin fetar. Nuk ekziston një planprogram kombëtar i mësimin, mirëpo qeveria ofron udhëzues. Në edukimin fetar fëmijët vrasin mendjen rreth disa prej pyetjeve më të thella të jetës siç është 'Cili është qëllimi ynë jetësor?' 'Pse vuajnë njerëzit?' Ata mësojnë se si u përgjigjet këtyre pyetjeve Krishterimi dhe fetë e tjera.

Në fazën kyçe 3 nuk ka gradime për edukimin fetar. Madje nëse mendoni që është më mirë për fëmijën tuaj, keni të drejtë edhe ta largoni nga orët e edukatës fetare.

Edukimit Personal, Social dhe Shëndetësor (PSHE)

Në PSHE nxënësit mësojnë për *shkathësitë personale*, siç janë si të merren vendimet e pavarura dhe si t'i vendosësh vetes një qëllim; *shkathësisë sociale* për t'i dëgjuar me ndjeshmëri dhe me respekt mendimet e të tjerëve dhe të mësosh se si të sillesh ndaj dhunës dhe sjelljeve asociale.

Disa prej këtyre shkathësive mund të mësohen në kuadër të lëndëve të tjera: për shembull, mësimi i shkencës do t'iu ofrojë nxënësve informacione lidhur me ndryshimet që paraqiten gjatë pubertetit.

Edukimi mbi seksin dhe lidhjet (SRE)

Të gjitha shkollat e mesme të financuara nga shteti përfshijnë edhe edukimin mbi seksin dhe lidhjet (SRE) në kuadër të planprogramit të tyre mësimor. Planprogrami Mësimor Kombëtar për shkencë parasheh që nxënësit duhet të mësohen për riprodhimin njerëzor seksual dhe për përhapjen e sëmundjeve. Shkollat janë përgjegjëse për përpilimin e strategjive të veta të SRE në përputhje me rekomandimet e qeverisë. Dimensionet emocionale dhe morale të marrëdhënieve seksuale zakonisht do të mësohen në kuadër të edukimit personal, social dhe shëndetësor.

Sipas ligjit (Ligji për Shkollimin nga viti 1996) keni të drejtë t'i nxirrni të rinjtë nga leksionet e edukatës seksuale, por jo nga aspektet gjegjëse të mësimin shkencor.

Edukimi për karrierën

Të gjitha shkollat duhet të ofrojnë një program të edukimit mbi karrierën për nxënësit e viteve shkollore 7-11, së bashku me një sasi të përshtatshme informatash lidhur me karrierën. Ato gjithashtu duhet t'u lejojnë zyrtarëve të Shërbimit të Ndërlidhjes [Connexions Service] që të kontaktojnë me nxënësit në çastet kyçe të vendimmarrjes gjatë shkollimit të tyre.

Objektivat dhe provimet

Shkollat i përdorin gradimet dhe provimet për të parë se ku kanë nevojë nxënësit për përmirësime, në mënyrë që ata të mund ta formësojnë mësimin e vet. Kjo u ndihmon

fëmijëve që të fitojnë kuptimin e arritjes së qëllimeve të pjeshme dhe kapërcimit më tutje.

Qeveria po ashtu me ndihmën e tyre kupton se sa fëmijë janë duke përparuar si duhet (posaçërisht në anglisht, matematikë dhe shkencë, ku fëmijët u nënshtrohen provimeve të Planprogramit Mësimor Kombëtar në moshën 14-vjeçare).

Qëllimi i gradimit është të jepen gradat që duhet t'i arrijë çdo fëmijë deri në një moshë të caktuar. Gradat 5 dhe 6 janë caqet që duhen arritur nga nxënësit 11-vjeçarë. Gjithmonë do të ketë fëmijë që janë nën ose mbi këto caqe.

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Crown, gusht 2006.